



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


9 JANAR 2023

** Vrojtimet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato u përfshinë në Programin e Komisionit Evropian për Harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit. Nga muaji qershor 2021, publikimi i analizave dhe të dhënave nga vrojtimet bëhet me frekuencë mujore.*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) regjistroi rritje me 2.7 pikë në muajin dhjetor. Niveli aktual i tij, 105.7 pikë, u rrit për të dytin muaj me radhë (Grafik 1). Rritja e TNE-së reflektoi përmirësimin e besimit në të gjithë sektorët e biznesit, ku ndikimin më të madh e patën sektori i ndërtimit dhe i industrisë. Paralelisht me to, treguesi i besimit të konsumatorëve vijoi përmirësimin edhe në këtë muaj (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) rezultoi në rritje me rreth 2.9 pikë përqindje krahasuar me muajin e kaluar, i ndikuar nga përmirësimi i të gjithë treguesve përbërës të tij. Ndër ta veçohen rritja e balancës për *prodhimin aktual* dhe ajo e *kontratave porositëse*. Gjithashtu, bizneset presin rritje të *prodhimit* në të ardhmen, kundrejt pritjeve në rënie për *punësimin* dhe për çmimet e *produkteve* të tyre (Tabelë 2, sektori i industrisë).

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) u rrit me 5.5 pikë përqindje në muajin dhjetor, duke regjistruar përmirësim të ndjeshëm të treguesit për të dytin muaj radhazi. Ky zhvillim u ndikua nga përmirësimi i balancave për *aktivitetin ndërtues* dhe për *kontratat porositëse*. Ndërkohë, pritjet për punësimin dhe ato për çmimet në të ardhmen shënuan rënie (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.
Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) shënoi rritje të lehtë me rreth 0.7 pikë përqindje në muajin dhjetor, ndikuar nga performanca më e mirë e treguesit të *ecurisë së biznesit*. Bizneset në aktivitetin e shërbimeve vlerësojnë se ka rritje të *punësimit* aktual, ndërkohë që pritjet për të ardhmen janë në rënie. Ecuria e çmimeve të shërbimeve në të ardhmen e afërt pritet të jetë në kahun rënës (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

Treguesi i besimit në tregti (TBT) vijoi prirjen rritëse, me rreth 1.8 pikë përqindje në këtë muaj. Treguesi u ndikua nga vlerësimet më pozitive për *ecurinë aktuale të biznesit* dhe për *punësimin* në të ardhmen. Pritjet për çmimet në të ardhmen u vlerësuan në rënie (Tabelë 2, sektori i tregtisë).


Treguesi i besimit konsumator (TBK) rezultoi i përmirësuar me rreth 1.8 pikë përqindje në muajin dhjetor, por duke vijuar të mbetet poshtë mesatares afatgjatë (Grafik 2). Treguesi pasqyro vlerësimin më pozitiv të konsumatorëve lidhur me *blerjet në shumë të mëdha*, si në periudhën aktuale ashtu edhe në të ardhmen. Konsumatorët vlerësojnë me rënie *ecurinë aktuale të çmimeve*, situatë e cila pritet të vijojë edhe në të ardhmen (Tabelë 2, konsumatorët).

Treguesit me frekuencë tremujore¹ shfaqën në përgjithësi një ecuri më pozitive krahasuar me rezultatet e vërtetimit të tre muajve më parë. *Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve* shënoi rritje në sektorët e ndërtimit (+1.8 pp, në nivelin 74.8%), tregtisë (+1.2 pp, në nivelin 74.3%) dhe shërbimeve (+0.5 pp, në nivelin 79.3%). Ky tregues rezultoi lehtësisht me rënie në sektorin e industrisë (-0.4 pp, në nivelin 80.3%).

¹ Pyetjet mbi normën e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe gjendjen financiare kanë frekuencë tremujore. Ato përfshihen në pyetësorët e bizneseve të muajve mars, qershor, shtator dhe dhjetor.


Gjendja financiare e bizneseve u përkeqësua për sektorët e industrisë dhe tregtisë, kundrejt rritjes së shënuar për sektorët e ndërtimit dhe të shërbimeve, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022.

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shuma të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve*

	Vlerat			2022						Situata aktuale	
	min	mes	max	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Koniunkturale**	Strukturore***
Industri	-59.6	-11.0	6.0	2.1	-2.4	-2.2	-6.9	-10.5	-7.6	↑	+
Ndërtim	-57.4	-25.9	-5.1	-11.2	-5.1	-10.7	-18.2	-10.8	-5.3	↑	++
Shërbime	-45.3	7.0	26.4	19.4	13.3	10.8	10.6	14.2	14.9	↑	+
Tregti	-32.0	-1.4	17.9	7	1.8	3.0	0.7	1.5	3.3	↑	+
Konsumator	-39.8	-26.7	-16.3	-35.0	-32.8	-35.7	-34.9	-33.8	-32.0	↑	-

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

***) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

****) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2022								
	Prill	Maj	Qersh.	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nënt.	Dhjet.
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	19.6	28.3	28.2	20.9	18.7	17.1	12.3	8.9	13.1
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-17.8	-14.0	-2.9	-8.2	-9.6	-8.0	-14.1	-17.6	-16.2
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-17.6	-16.9	-8.1	-6.4	-16.4	-15.6	-18.8	-22.8	-19.8
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-7.2	-6.0	-6.2	-6.3	-6.9	-0.3	-1.3	-3.8	-5.1
Prodhimi pritje (pyetja 5)	27.8	30.2	25.7	29.9	34.2	31.0	32.1	33.7	35.0
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	66.6	50.2	50.8	50.9	30.8	47.7	35.7	30.8	26.9
Punësimi pritje (pyetja 7)	14.6	17.8	14.5	11.4	-9.5	9.3	10.7	7.0	6.5
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	2.3	3.8	10.9	6.8	24.4	6.5	3.5	5.7	10.9
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-33.5	-30.7	-28.0	-29.1	-34.6	-27.8	-39.9	-27.4	-21.5
Punësimi pritje (pyetja 4)	-0.2	5.3	7.5	4.8	21.6	12.1	7.8	16.4	7.9
Çmimet pritje (pyetja 5)	44.6	33.0	47.3	41.0	39.7	39.0	43.9	44.1	32.3
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	21.3	25.7	25.5	21.9	13.6	11.2	9.0	13.9	14.7
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	17.8	27.1	27.3	16.9	12.9	10.4	12.2	14.4	15.2
Kërkesa pritje (pyetja 3)	27.4	37.0	36.9	35.9	25.8	31.6	20.6	25.6	23.0
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	13.5	9.8	21.1	5.1	6.4	3.7	5.4	3.4	4.1
Punësimi pritje (pyetja 5)	11.1	12.6	6.2	7.4	8.6	14.8	5.6	8.0	6.1
Çmimet pritje (pyetja 6)	38.7	44.4	35.3	34.6	23.9	27.3	30.3	20.2	19.8
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	6.3	14.2	13.0	11.5	3.0	5.2	-0.7	0.2	1.0
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	2.9	5.0	1.4	0.5	5.1	0.8	1.0	3.1	3.0
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	7.1	13.4	16.0	21.4	12.1	12.0	14.4	17.4	21.1
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	12.7	14.6	23.5	22.1	15.6	17.7	15.5	22.4	27.5
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	-1.8	3.8	2.8	1.7	0.5	0.8	2.1	2.7	5.7
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	50.3	45.5	39.3	43.8	37.0	41.5	30.9	28.4	24.8
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-17.3	-17.8	-18.5	-19.9	-15.9	-18.9	-21.3	-20.1	-20.8
Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	-7.4	-6.3	-5.2	-7.2	-4.4	-4.3	-5.5	-3.8	-3.5
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-31.0	-31.2	-29.9	-32.3	-30.2	-32.1	-32.4	-31.8	-30.6
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	-16.1	-10.5	-12.6	-12.5	-6.4	-15.6	-13.5	-12.4	-9.8
Çmimet aktuale (pyetja 5)	52.9	50.4	51.6	53.7	52.0	49.5	53.6	48.6	46.0
Çmimet pritje (pyetja 6)	5.5	3.6	6.0	2.8	0.2	3.4	2.6	-3.9	-9.2
Papunësia pritje (pyetja 7)	11.8	10.6	10.1	10.2	9.2	12.5	14.5	8.6	11.1
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-69.2	-68.8	-69.1	-66.5	-66.1	-68.0	-66.4	-66.1	-64.6
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-50.9	-50.6	-52.5	-53.6	-54.2	-54.9	-54.4	-53.1	-50.1
Kursimi aktual (pyetja 10)	-47.7	-47.3	-48.1	-49.4	-48.3	-49.5	-48.0	-47.5	-43.1
Kursimi pritje (pyetja 11)	-47.8	-45.8	-46.3	-45.7	-44.2	-44.7	-44.4	-42.1	-41.1
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	0.0	0.1	0.2	1.8	2.4	1.1	1.1	2.0	1.3

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.